

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 425, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE NË INSTITUCIONET PLOTËSUESE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim realizimin e indeksimit dhe rritjes së pagave për punonjësit mësimorë, për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe për punonjësit e tjerë jomësimorë, që shërbejnë në institucionet arsimore dhe në ato plotësuese, të sistemit arsimor parauniversitar, në zbatim të kompetencës së Këshillit të Ministrave për të miratuar masën e indeksimit dhe rritjet e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi hartohet si pasojë e detyrimit ligjor që ka Këshilli i Ministrave për të miratuar masën e indeksimit dhe rritjet e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i paraqitur është hartuar në bazë të përcaktimit të dhënë në shkronjat "a" dhe "b", të nenit 8, ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, për zbatimin e kompetencës që ka Këshilli i Ministrave për të miratuar rritjet e

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar".

pagave dhe masën e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

Indeksi i pagave për vitin 2026 bazohet në indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit, të deklaruar/shpallur nga qeveria shqiptare në masën 2.5% dhe do të realizohet për të gjithë punonjësit mësimorë dhe punonjësit e tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar, për vitin 2026, njëjtë si edhe për funksionarët/nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet e administratës publike.

Nëpërmjet këtij projektvendimi realizohet indeksimi në masën 2.5% i elementit të pagës bruto mujore “paga për pozicion”. Ndërkohë meqenëse llogaritja e elementit tjetër të pagës bruto mujore “shtesa për vjetërsi në punë” aplikohet mbi pagën për pozicion, automatikisht edhe ky element indeksohet me 2.5% deri në 5.17%.

Më konkretisht indeksimi i vlerave të pagës për pozicion, reflektohet në të tre lidhjet e pagave të vendimit nr. 425/2024, aktualisht në fuqi, për punonjësit mësimorë, për punonjësit e shërbimit psiko-social, dhe për punonjësit e tjerë jomësimorë, të institucioneve arsimore dhe plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar.

Gjithashtu, për punonjësit e sistemit të arsimit parauniversitar, si edukatorë, kujdestar konvikti, mësues, punonjës psiko-social, oficer i sigurisë, instruktorë dhe koordinatorë të cilët aktualisht kanë një vlerë të pagës për pozicion nga 58,000 lekë në muaj deri në 74,000 lekë në muaj, nëpërmjet këtij projektvendimi, parashikohet përveç indeksimit në masën 2.5%, edhe një rritje e vlerës së pagës për pozicion, duke e çuar rritjen e pagave për këta punonjës në total në masën 3,000 lekë në muaj, apo 4 deri në 5.17%.

Nga miratimi i këtij projektvendimi përfitojnë rreth 36,390 punonjës mësimorë dhe jomësimorë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të:

- nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi që po paraqesim, propozohet nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, dhe ka 4 pika dhe 3 (tre) lidhje bashkëlidhur që propozojnë sa vijon:

Pika e parë: përcakton zëvendësimin e lidhjeve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3;

Pika e dytë: përcakton që vlerat e elementit “paga e pozicionit”, për: a) pozicionet me numër rendor 1 deri në 6, të lidhjes nr. 1, pozicionet me numër rendor 1 dhe 2, të lidhjes nr. 2 dhe pozicionet me numër rendor 1 deri në 4, të lidhjes nr. 3, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave; b) pozicionet e tjera, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

Pika e tretë: përcakton përballimin e efekteve financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi;

Pika e katërtë: përcakton institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e vendimit janë Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si institucionet përfutuese nga miratimi i këtij vendimi që kanë në varësi të tyre institucionet arsimore dhe plotësuese të sistemit të arsimit parauniversitar.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe është dakordësuar në fazën e përgatitjes së tij me përfaqësues të ministrisë së Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij vendimi sjell efekte financiare, efekte që janë llogaritur sipas organizimit dhe varësisë së institucioneve arsimore, e konkretisht:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”.

- Për 30,000 punonjës mësimorë dhe punonjës psikologë/punonjës social dhe oficerë të sigurisë në institucionet arsimore të sistemit të arsimit parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, efektet llogariten rreth 114.5 milionë lekë në muaj për pagat dhe sigurime shoqërore e shëndetësore;
- Për 1,500 punonjës mësimorë të sistemit të arsimit profesional, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, efektet llogariten rreth 6 milionë lekë në muaj për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore;
- Për 4,890 punonjës mësimorë të sistemit të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe të konvikteve shkollore, efektet llogariten rreth 16.7 milionë lekë në muaj për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2026, të përballohen nga buxheti i institucioneve përkatëse, të miratuara në ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”. Për njësitë e vetqeverisjes vendore, përballohen nga transfertat e miratuar në ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUESI
MINISTRI I SHTETIT
PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN
ADEA PIRDENI

Adea
Pirdeni

Digitally signed by Adea
Pirdeni
Date: 2025.01.15 10:41:01
+0200

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”.